“Kur dikush planifikon të therë kurban, pasi të jetë parë hëna e re e muajit dhulhixhe, të mos shkurtojë asgjë nga qimet e as nga thonjtë, derisa ta therë kurbanin.”

Nëna e besimtarëve, Umu Seleme (Allahu qoftë i kënaqur me të!), bashkëshortja e Profetit ﷺ, transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Kur dikush planifikon të therë kurban, pasi të jetë parë hëna e re e muajit dhulhixhe, të mos shkurtojë asgjë nga qimet e as nga thonjtë, derisa ta therë kurbanin.”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith urdhëroi që ai që dëshiron të therë kurban, të mos presë asgjë nga flokët, as nga sqetullat, as nga mustaqet, as nga ndonjë pjesë tjetër e trupit; as nga thonjtë e duarve apo të këmbëve, pasi të jetë parë hëna e re e muajit Dhulhixhe, derisa të kryejë therjen e kurbanit.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/8954